



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Proces-verbal

Të dhëna të përgjithshme

Takimi publik për konsultimin e prezantimit : Buxhetimi me Pjesëmarrje, investimet dhe zhvillimi i zonës në fokus- **Njesia Administrative Shirgjan**

Data e takimit: 16.10.2025

Vendi i takimit: Njesia Administrative Shirgjan

Ora e hapjes së takimit: 12:00

Pjesëmarrës në takim gjithsej 99

Femra 21

Meshkuj 78

Kryesuesi i takimit: Kryetari I Bashkisë Z.Gledian Llatja, Administrator I Nj.A Shirgjan Z.Ibrahim Roçi, banorë të Nj.A Shirgjan.

Zhvillimi i takimit. Në Njësinë Administrative Shirgjan u zhvillua takimi i radhës i Buxhetimit me pjesëmarrje. Kryetari I Bashkisë Z.Gledian Llatja nënvizoi se unaza bujqësore ka lehtësuar tregun, duke përmirësuar qarkullimin e produkteve bujqësore, si edhe punimeve sistematike për hapjen dhe pastrimin e kanaleve kulluese dhe vaditëse. Këto investime kanë ndihmuar jo vetëm për tregtimin e produkteve, por edhe për rritjen e prodhimit bujqësor në fushën e Elbasanit. Problemet kanë qenë të shumta, nga 10 hektarë sera që kemi pasur në fushën e Elbasanit, kryesisht në Bujqës dhe Jagodinë, tashmë kemi mbi 120 hektarë sera për bujqësi, me një prodhim bujqësor të shtuar në fushën e Elbasanit, "Sot flitet për problemet që kemi me bujqësinë, duke filluar që nga tregu, pikat e grumbullimit, duke vazhduar me kodrat, me ullishtat, me vajin e ullirit." Jemi përpjekur t'ju qëndrojmë gjithnjë pranë, duke pohuar se "përveç problemeve, ka pasur edhe një rritje konstante të ekonomisë në të gjithë fushën e Elbasanit, dhe kjo kryesisht e ardhur nga bujqësia. Një sërë investimesh kemi bërë gjatë këtyre viteve dhe shumë investime të tjera që pritet t'i bëjmë. Qëllimi ynë nuk është të rregullojmë vetëm pjesën e infrastrukturës, por kemi edhe projekte zhvillimore të Elbasanit. Shumë nga problematikat që janë zgjidhur, janë zgjidhur nga buxhetimi me pjesëmarrje, nga kërkesat që ju keni bërë. Ajo që kam vënë re është që në çdo njësi administrative, nëse kemi vënë prioritet për tre apo katër investime, kemi arritur që gjatë të gjithë kohës të bëjmë më shumë." Flasim për paketën fiskale dhe shërbimet që ne ofrojmë, bashkë me tarifatat e pastrimit, ndricimit dhe gjelbërimit në fshat dhe në qytet. Ne sot në Bashkinë e Elbasanit kemi tarifatat më të ulta sesa Bashkitë e tjera. E kemi 60% më të ulët sesa Tirana, 40% më të ulët sesa Durrësi dhe Fieri. Do të kemi një rritje në tarifën e pastrimit, më tepër në qytet e më pak

në zonat rurale. Rritja do të fillojë nga 16%-24% për familjet dhe për bizneset. Nuk rritet as në qytet e as në fshat më shumë se 600 lekë të reja në vit. Në fshat nuk shkon më shumë se 1.900 lekë të reja në vit ndërsa në qytet nuk bëhet më shumë se 2400 lekë të reja në vit. Është një tarifë e ulët pasi edhe makinat e reja që po blejmë, mirmbajtja e koshave dhe ardhja përditë e mjeteve kanë një kosto të caktuar të cilën nuk e mbulojmë dot pavarësisht se po e rrisim nga 16%-24%. Nuk duam ti rrisim tarifat më shumë se çmundemi, tarifat zakonisht kanë 20%-in e vet, do të kemi rritje në tarifën e pastrimit dhe në tarifën e ndriçimit. Koncepti I vetëm i tarifave është që shpenzimet që bën Bashkia duhet të jenë të njëjta me tarifimin që ka popullata. Çdo vit do përpiqemi të kemi një indeksim të çmimit dhe të tarifës së vlerës e cila do të bëhet për ofrimin e shërbimeve.

Në përmbyllje, banorët e Shirgjanit votuan për prioritetet që do të përfshihen në buxhetin e vitit 2026 dhe shprehën falënderimet e tyre për investimet e realizuara gjatë vitit në zonën e tyre.

Prioritet e banorëve të Nj.A Shirgjan:

Banori 1:

- Kanalizimi i ujit të pijshëm
- Hapja e rrugës bujqësore Shirgjan-Bujqës, KUZ dhe riparime
- Pastrimi i kanalit vaditës
- Asfaltimi i dy rrugëve kryesore të fshatit dhe restaurimi i shkollës së mesme
- Shtrim i rrugës në lagjen e 'Bibajve'

Prioritet e Fshatit Kryezjarr:

Banori 2:

- Shtim i koshave të mbetjeve urbane
- Pastrim dhe çakullim i rrugës në lagjen 'Balla'
- Përfundimi i unazës së fshatit
- Meremetimi i rrugës së varrezave të fshatit
- Uji i pijshëm

Prioritet e Fshatit Mjekës:

Banori 3:

- KUZ tek rruga e 'Bajramëve'
 - Pastrimi i rrugëve të ullishtave
 - Polica të shtrirë
 - Asfaltimi i rrugës në lagjen 'Fushës'
-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Prioritet e Fshatit Jagodinë:

Banori 4:

- Çakullimi i rrugës në lagjen e 'Kasallarëve'
- Pastrimi i kanalit kullues
- Ndriçimi i rrugës
- Uji i pijshëm në fshat
- Shtim i koshave të mbetjeve urbane (orari)
- Shtrim i rrugës së varrezave (uji i pijshëm)

Prioritet e Fshatit Bathës:

Banori 5:

- Shtrim i rrugëve dhe lagjeve të fshatit
- Betonim i rrugës në lagjen 'Çekrezëve'
- Shtrim i rrugës së varrezave
- Mungesë e ujit të pijshëm në fshat

Prioritet e Fshatit Kuqan:

Banori 6:

- Tubacionet e ujit të pijshëm në fshat
 - Asfaltim i rrugës 'Çesmja e shkollës'
-

Prioritet e Fshatit Bujqës:

Banori 7:

- Ndriçim i rrugës tek shkolla (600 m kabëll)
- Pastrim kanalesh në lagjen 'Shmilse'
- Zhavorrim i rrugës bujqësore
- Pastrime kanalesh në lagjen e 'Buzanëve'
- Ndriçues për fshatin dhe ndriçim i rrugës Bujqës-Jagodinë
- Shtrim i unazës në lagjen e 'Kavajsëve'

Mbyllja e takimit. Ora 13:09

Përgjegjëse e Konsultimeve Publike

Alba Papa





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Proces-verbal

Të dhëna të përgjithshme

Takimi publik për konsultimin e prezantimit : Buxhetimi me Pjesëmarrje, investimet dhe zhvillimi i zonës në fokus- **Njësia Administrative Bradashesh**

Data e takimit: 20.10.2025

Vendi i takimit: Pranë Njesisë Administrative Bradashesh

Ora e hapjes së takimit: 15:00

Pjesmarrës në takim gjithsej 84

Femra 36

Meshkuj 48

Kryesuesi i takimit: Nënkryetari I Bashkisë Z.Asim Sula,Deputetja e zonës Znj.Sara Mila ,Kryetar I partisë Bradashesh Z.Kadri Salla,Administrator i Njesisë Administrative Z.Edmond Muça,banorë të njesisë .

Zhvillimi i takimit. Buxhetimi me pjesëmarrje në Bradashesh, prioritet rikthimi i ish-Metalurgjikut në zonë ekonomike dhe rekreative.

Kryetari theksoi se Bashkia Elbasan ka nisur një proces të gjerë diskutimesh për hartimin e masterplanit të zonës së ish-Metalurgjikut, me synimin për ta shndërruar atë në një hapësirë të kombinuar prodhimi dhe rekreative, në shërbim të banorëve të Bradasheshit dhe të gjithë Elbasanit.

“Kemi filluar një projekt të madh për ta kthyer zonën industriale të Metalurgjikut në një ambient, jo vetëm për prodhim, por edhe për rekreativitet.

Po punojmë që të zhvillojmë modelet më të mira të ekonomisë së gjelbër. Kemi bashkëpunuar ngushtë me banorët për sistemime, hapje rrugësh, rrugët e arave, si dhe për zgjidhjen e problematikave të përditshme,” tha Kryetari.

Ai shtoi se Bashkia Elbasan po vijon me rritje të buxhetit falë performancës së mirë dhe menaxhimit efikas të të ardhurave, dhe se çdo projekt i propozuar nga banorët do të vlerësohet sipas prioriteteve reale të zonës.

Nga ana e saj, deputetja Sara Mila vlerësoi procesin e buxhetimit me pjesëmarrje si një tregues të qartë të demokracisë vendore, ku qytetarët përfshihen drejtpërdrejt në vendimmarrje. Buxheti me pjesëmarrje është një praktikë që ka dhënë rezultate konkrete. Bashkia e Elbasanit po tregon se dëgjon qytetarët dhe përcakton prioritetet sipas nevojave të tyre. Ndaj garantoj se nga ana e qeverisë qendrore do të mbështesim çdo projekt që ndihmon zhvillimin e zonës,

Takimi në Bradashesh është pjesë e turit të konsultimeve publike të Bashkisë Elbasan, për përgatitjen e buxhetit të vitit të ardhshëm, me synimin që çdo vendim të bazohet në nevojat reale të komunitetit.

Prioritet e banorëve të Nj.A Bradashesh:

Banori 1:

- Pastrim i kanalit kryesor (kanal kullues)
- Zgjerim kolektori për ujin e pijshëm
- Shtim i koshave të mbetjeve urbane
- Ndriçim
- Mungesë territori varrezash për lagjen e 'Pallateve'
- Hapja e rrugëve për ullishtat
- Rikonstruktion i tualeteve në shkollën 'Alush Lleshanaku' dhe riparim i kaldajës
- Shtrim rruge në lagjen 'Çesmja e Kasinës'

Prioritet e Fshatit Balëz Lart:

Banori 2:

- Uji i pijshëm
- Rikonstruktion i rrugës së varrezave

Prioritet e Fshatit Reçëm:

Banori 3:

- Uji i pijshëm (uji i Gurrës mungesë)
- Shtrim i rrugës nga Karakullaku-Reçëm
- Betonim i rrugës Shijon-Reçëm
- Mungesë e ujit për kanalet vaditëse në lagjen e 'Gavallarëve'

Prioritet e Fshatit Shtëmaj:

Banori 4:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

- Shtrim i rrugës kryesore që lidhet me rrugën e fshatit dhe varrezat

Prioritet e Fshatit Petresh:

Banori 5:

- Asfaltim i rrugës në hyrje të fshatit (1.2 km)

Prioritet e Fshatit Ulem:

Banori 6:

- Ndërtim i rrugës dytësore që lidh fshatrat Ulem-Shtëmaj-Kozan-Reçan
- Uji i pijshëm
- Lidhja e fshatit me autostradën

Prioritet e Fshatit Rrilë:

Banori 7:

- Shtrimi i rrugës kryesore të fshatit
- Ujë për kanalet vaditëse
- Uji i pijshëm

Prioritet Uzina 12:

Banori 8:

- KUZ

Prioritet e Fshatit Katund i Ri:

Banori 9:

- KUZ
 - Mungesë orari për ujin e pijshëm
 - Zgjerimi i varrezave të fshatit
 - Mjet transporti urban Fushmbret-Katund i Ri
 - Asfaltime të vogla rrugësh
 - Shtrim i rrugës që lidh shkollën me qendrën e fshatit
 - Shtrim rruge në lagjen e sipërme
 - Ambjente sportive në shkolla
-

- Sistemim, parkim, KUZ (pallati 3 katësh)
- Çakullim i rrugës në lagjen 'Sheshi 4'

Prioritet e Fshatit Fikas:

Banori 10:

- Riparime segmentesh rrugore
- Ndriçim i fshatit

Prioritet e Fshatit Kusarth:

Banori 11:

- KUZ

Mbyllja e takimit. Ora 16:13

Përgjegjëse e Konsultimeve Publike

Alba Papa





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Proces-verbal

Të dhëna të përgjithshme

Takimi publik për konsultimin e prezantimit : Buxhetimi me Pjesëmarrje, investimet dhe zhvillimi i zonës në fokus- **Njësia Administrative Funar**

Data e takimit: 20.10.2025

Vendi i takimit: Pranë Njesisë Administrative Funar

Ora e hapjes së takimit: 10:00

Pjesëmarrës në takim gjithsej 36

Femra 11

Meshkuj 15

Kryesuesi i takimit: Nënkryetari I Bashkisë Z.Asim Sula,Deputetja e zonës Znj.Sara Mila,Administrator i Njesisë Z.Fisnik Bozha,banorë të Njesisë Administrative Funar.

Zhvillimi i takimit. Procesi i Buxhetimit me Pjesëmarrje ka vijuar në Njësinë Administrative Funar, një nga zonat me potencialin më të madh turistik dhe natyror të Bashkisë Elbasan.

Nënkryetari i Bashkisë Elbasan, Z.Asim Sula, cili vlerësoi kontributin e komunitetit dhe evidentoi investimet e rëndësishme që janë realizuar gjatë këtij viti në këtë zonë.

Gjatë diskutimit, u theksua se Funari tashmë është përfshirë në “Paketën e Maleve”, si një nga zonat që do të përfitojnë projekte të dedikuara për zhvillimin e infrastrukturës rurale dhe turizmit të qëndrueshëm.

Investimet e kryera dhe ato që pritet të nisin së shpejti, po i japin zonës një dinamikë të re zhvillimi, duke e kthyer në një qendër të rëndësishme për turizmin natyror dhe aventuror.

Z.Asim bëri me dije se në muajin nëntor do të nisë edhe një projekt i ri në bashkëpunim me një organizatë në Elbasan dhe Bashkinë Elbasan, që ka të bëjë me ndërtimin e një Parku Aventurash modern, që do të sjellë zhvillim të zonës dhe një atraksion të ri turistik për Funarin.

Gjatë kësaj periudhe, në Funar janë realizuar ndërhyrje të rëndësishme në mirëmbajtjen e rrugëve rurale, pastrimin e kanaleve kulluese dhe sistemimin e rezervuarëve në Mollagjesh e Cërujë, si dhe rehabilitimi i aksit Letan-Funar, që ka lehtësuar ndjeshëm qarkullimin e banorëve dhe vizitorëve.

Në kuadër të strategjisë për zhvillimin e turizmit malor, në Funar tashmë janë hapur bujtinat e para, si “Bujtina Agim”, që ofrojnë mikpritje dhe akomodim për turistë vendas dhe të huaj.

Zonës i janë shtuar gjithashtu aktivitete të reja turistike dhe sportive, që po e kthejnë Funarin në një destinacion të preferuar për pushime dhe aventura.

Peizazhi i veçantë i zonës, me katër liqene të shpërndarë përreth fshatit, ofron mundësi për aktivitete si kajak dhe kanoe, ndërsa projekti në zhvillim “Funari Adventure Park” do të përfshijë një pistë parashutizmi, mbi 75 km shtigje malore dhe një qendër informimi për vizitorët, duke krijuar kushte për turizëm aktiv gjatë gjithë vitit.

Në kuadër të Buxhetimit me Pjesëmarrje, banorët parashtruan edhe propozime për projekte të tjera që lidhen me turizmin, bujqësinë dhe përmirësimin e infrastrukturës publike, duke u bërë pjesë aktive e procesit të vendimmarrjes për zhvillimin e komunitetit të tyre.

Prioritet e Fshatit Cerujë:

Banori 1:

- Zhavorrim dhe hapje e rrugëve kryesore të fshatit dhe KUZ
- Mungesë në transportin rrugor
- Rikonstruksion i shkollës së fshatit

Prioritet e Fshatit Bixëlle:

Banori 2:

- Shtrim i rrugës së fshatit
- Pastrimi i kanaleve kulluese
- Pastrim dhe hapja e rrugës në lagjen ‘Brigada I’

Prioritet e Fshatit Preça e Sipërme:

Banori 3:

- Karikim rruge me çakull
-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Prioritet e Fshatit Mollagjesh:

Banori 4

- Shtrim i rrugës kryesore të fshatit (150 m)
- Mungesë e ujit të pijshëm në shkollë
- Hapja dhe pastrimi i rrugëve të lagjeve të fshatit

Mbyllja e takimit. Ora 11:00

Përgjegjëse e Konsultimeve Publike

Alba Papa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Proces-verbal

Të dhëna të përgjithshme

Takimi publik për konsultimin e prezantimit : Buxhetimi me Pjesëmarrje, investimet dhe zhvillimi i zonës në fokus- Njësia Administrative Gjergjan

Data e takimit: 15.10.2025

Vendi i takimit: Pranë Njesisë Administrative Gjergjan

Ora e hapjes së takimit: 13:15

Pjesmarrës në takim gjithsej 46

Femra 8

Meshkuj 38

Kryesuesi i takimit: Kryetari I Bashkisë Z.Gledian Llatja,Deputetja e zonës Znj.Evis Kushi,Nënkryetare e Këshillit Bashkiak Znj.Enerieta Ferra,Administrator i Njesisë Administrative Z.Alfred Mukja,banorë të njësisë .

Zhvillimi i takimit. Kryetari i njësisë bëri një përmbledhje të punëve të realizuara gjatë vitit, mes të cilave u përmendën, asfaltimi i rrugës Muriqan - Gjergjan, ndërhyrje në infrastrukturën rrugore në fshatin Thanë, sisteme dhe asfaltime në fshatin Gjergjan, punime për rrugën Kodër Bujaras – Bujaras.

Kryetari prezantoi projektet që po realizohen dhe planifikimet e reja për përmirësimin e infrastrukturës rurale.

“Jemi duke investuar në shtrimin e rrugëve në disa fshatra dhe lagje të brendshme, përfshirë Bujaras dhe Kodër Bujaras, një premtim i kahershëm tashmë i mbajtur,” tha ai.

Kryetari shtoi se tashmë Bashkia Elbasan ka ngritur një ndërmarrje të veçantë për zonat rurale, ASHP, dhe synon të krijojë edhe dy struktura të dedikuara për zonën poshtë dhe lart të Shkumbinit, me qëllim që shërbimet dhe mirëmbajtja e rrugëve të jenë më pranë banorëve.Përveç Buxhetimit me Pjesëmarrje do të flasim edhe për paketën fiskale.Ne sot në Bashkinë e Elbasanit kemi tarifën më të ulta sesa Bashkitë e tjera.E kemi 60% më të ulët sesa Tirana, 40% më të ulët sesa Durrësi dhe Fieri.Do të kemi një rritje në tarifën e pastrimit, më tepër në qytet e më pak në zonat rurale.Rritja do të fillojë nga 16%-24% për familjet dhe për bizneset.Nuk rritet as në qytet e as në fshat më shumë se 600 lekë të reja në vit.Në fshat nuk shkon më shumë se 1.900 lekë të reja në vit ndërsa në qytet nuk bëhet më shumë se 2400 lekë të reja në vit.Është një tarifë e ulët pasi edhe makinat e reja që po blejmë,mirëmbajtja e

koshave dhe ardhja përditë e mjeteve kanë një kosto të caktuar të cilën nuk e mbulojmë dot pavarësisht se po e rrisim nga 16%-24%. Nuk duam ti rrisim tarifën më shumë se çmimi, tarifën zakonisht kanë 20%-in e vet, do të kemi rritje në tarifën e pastrimit dhe në tarifën e ndriçimit. Koncepti i vetëm i tarifave është që shpenzimet që bën Bashkia duhet të jenë të njëjta me tarifimin që ka popullata. Çdo vit do përpiqemi të kemi një indeksim të çmimit dhe të tarifës së vlerës e cila do të bëhet për ofrimin e shërbimeve.

Deputetja Evis Kushi vlerësoi angazhimin e Bashkisë Elbasan dhe theksoi se “bashkëpunimi i të gjithëve është i domosdoshëm për të ecur përpara dhe për të sjellë më shumë punë të mira në këtë zonë.”

Ajo nënvizoi se Kryetari e ka gjithmonë në vëmendje zhvillimin e zonave rurale si Gjergjani e Shirqjani si zona bujqësore apo fshatra të tjerë që kanë potencial turistik.

Banorët patën mundësinë të shprehin nevojat e tyre dhe të vendosin së bashku prioritetet për zhvillimin e komunitetit.

Prioritet e banorëve të Nj.A Gjergjan:

Banori 1:

- Shtrim rruge tek repart ushtarak (800 m)
- Uji i pijshëm
- Shtrim i rrugës së ‘Mukallarëve’ si dhe rrugës së ‘Zogut’
- Stola për sheshin tek qendra e fshatit
- Rikonstruktion i urës që lidh fshatin

Prioritet e Fshatit Kështjellë:

Banori 2:

- Shtrim i rrugës së fshatit Kështjellë si dhe 2 km që lidh fshatin Kështjellë-Bujaras
- Shtim i koshave për mbetjet urbane

Prioritet e Fshatit Gjonme:

Banori 3:

- Pastrim kanali
 - Pastrim i përroit Gjonme
-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Prioritet e Fshatit Thanë:

Banori 4:

- Sanitare për shkollën
- Shtrim i rrugës së varrezave dhe pastrim i kanaleve kulluese

Prioritet e Fshatit Kodra Bujares:

Banori 5:

- Shtrim i rrugëve nëpër lagjet e fshatit
- Ujë i pijshëm
- Transformator për energjinë elektrike

Prioritet e Fshatit Muriqan:

Banori 6:

- Shtrim i 2 segmenteve të rrugës që lidh 2 lagjet
- Shtrim i rrugës tek tokat dhe pastrimi i kanaleve kulluese
- Ndriçim i fshatit

Mbyllja e takimit. Ora 14:25

Përgjegjëse e Konsultimeve Publike

Alba Papa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Proces-verbal

Të dhëna të përgjithshme

Takimi publik për konsultimin e prezantimit : Buxhetimi me Pjesëmarrje, investimet dhe zhvillimi i zonës në fokus- **Njësia Administrative Gjinar**

Data e takimit: 15.10.2025

Vendi i takimit: Sheshi Qender

Ora e hapjes së takimit: 10:00

Pjesmarrës në takim gjithsej 30

Femra 9

Meshkuj 21

Kryesuesi i takimit: Kryetari I Bashkisë Z.Gledian Llatja,Deputetja e zonës Znj.Evis Kushi,Kryetar I Këshillit Bashkiak Z.Lutfi Lala,Administrator i Njesisë Z.Emanuel Hida,banorë të Njesisë Administrative Gjinar.

Zhvillimi i takimit. Kryetari prezanton projekte të reja për zonën e Shpatit.

Procesi i buxhetimit me pjesëmarrje ka nisur këtë vit nga zona turistike e Gjinarit, aty ku janë kryer një sërë investimesh të dukshme, jo vetëm për zhvillimin turistik, por mbi të gjitha për rritjen e cilësisë së jetesës për banorët e zonës.

E njohur si një nga perlat e turizmit në Elbasan, Gjinari është parë si përparësi gjatë këtij viti si nga investimet e qeverisë shqiptare ashtu edhe nga vetë Bashkia Elbasan.

Në fjalën e tij, kryetari theksoi rëndësinë që ka zona e Shpatit për zhvillimin ekonomik dhe turistik të Elbasanit.Ne jemi mbledhur këtu për të diskutuar dhe për të marrë vendime për të ardhmen.

Zona e Shpatit meriton shumë sepse është një zonë me traditë, me kulturë, një zonë e cila ka një potencial ekonomik, por edhe njerëzor.

Kërkesa kryesore dikur këtu në Gjinar ishte qendra, sheshi kryesor ku edhe jemi sot, pasi i jep potencial të gjithë zones, jo vetëm Gjinarit, por edhe Lleshanit, Shelcanit, fshatrave të tjerë dhe Bukanikut, që është një nga malet tona më të bukura dhe krenaria e zonës sonë të Elbasanit.”

Kryetari shtoi se investimet në Gjinar kanë qenë të shumta dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e zonës:

“Kemi bërë shumë investime në Gjinar, sisteme rrugësh, lidhje të energjisë elektrike, ujësjellësin, si edhe sheshin që ka qenë një investim i madh.

Ne kemi investuar në Gjinar sepse duam ta bëjmë atë një destinacion turistik dhe të krenohemi të gjithë me bukurinë, traditën, kulinarinë dhe mikpritjen që e karakterizon,

Gjithashtu përveç investimeve të realizuara, Bashkia Elbasan po punon për projekte të reja që do të lehtësojnë qarkullimin dhe do të shtojnë mundësitë për zhvillim turistik.

“Do të vazhdojmë të bëjmë edhe më shumë. Kemi projekte për Gjinarin, po ecim drejt konkretizimit të një rruge të re nga Shushica për të ardhur në Lleshan nga pjesa e mbrapme, një projekt që kërkon investim, por që do të bëjë një rrugë më të shkurtër dhe do t'i japë Gjinarit një potencial të ri, pa lënë pas dore rrugën e vjetër dhe kërkesën tonë të vazhdueshme për mirëmbajtjen e saj,” theksoi Kryetari.

Përveç Buxhetimit me Pjesëmarrje do të flasim edhe për paketën fiskale. Ne sot në Bashkinë e Elbasanit kemi tarifë më të ulta sesa Bashkitë e tjera. E kemi 60% më të ulët sesa Tirana, 40% më të ulët sesa Durrësi dhe Fieri. Do të kemi një rritje në tarifën e pastrimit, më tepër në qytet e më pak në zonat rurale. Rritja do të fillojë nga 16%-24% për familjet dhe për bizneset. Nuk rritet as në qytet e as në fshat më shumë se 600 lekë të reja në vit. Në fshat nuk shkon më shumë se 1.900 lekë të reja në vit ndërsa në qytet nuk bëhet më shumë se 2400 lekë të reja në vit. Është një tarifë e ulët pasi edhe makinat e reja që po blejmë, mirëmbajtja e koshave dhe ardhja përditë e mjeteve kanë një kosto të caktuar të cilën nuk e mbulojmë dot pavarisht se po e rrisim nga 16%-24%. Nuk duam ti rrisim tarifën më shumë se çmimi, tarifën zakonisht kanë 20%-in e vet, do të kemi rritje në tarifën e pastrimit dhe në tarifën e ndriçimit. Koncepti i vetëm i tarifave është që shpenzimet që bën Bashkia duhet të jenë të njëjta me tarifimin që ka popullata. Çdo vit do përqipemi të kemi një indeksim të çmimit dhe të tarifës së vlerës e cila do të bëhet për ofrimin e shërbimeve.

Deputetja Evis Kushi vuri theksin tek investimet e kryera dhe tek interesi në rritje që ka treguar vetë kryetari i bashkisë për këtë zonë.

Gjatë këtij viti, paketa e maleve ka përfshirë edhe Gjinarin, si një zonë me potencial të madh turistik, ku janë kryer një sërë investimesh si hapja e muzeut, info point-it, etj. Kjo paketë ka si qëllim zhvillimin e turizmit dhe ekonomisë lokale.

Në përfundim të takimit, banorët shprehën kërkesat e tyre dhe u votua për prioritetet e investimeve, të cilat do të kalojnë më pas në buxhetin e vitit 2026, ku zërat e tyre dhe këto prioritetë do të vihen në zbatim nga Bashkia Elbasan.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Prioritet e banorëve të Nj.A Gjinar:

Banori 1:

- Rikonstruktion i rrugës Elbasan-Gjinar
- Mungesë energjie elektrike në disa zona
- Shtrim i rrugës së parcelave
- Treg ushqimor për fshatin
- Sistemim i rrugës së rezervuarit
- Sistemi i mbetjeve urbane
- Ndriçimi i fshatit

Prioritet e Fshatit Valesh:

Banori 2:

- Mungesë e energjisë elektrike
- Zhavorrim i rrugës Gjinar-Valesh
- Zhavorrim që lidh fshatin Xibresh

Prioritet e Fshatit Lleshan:

Banori 3:

- Ujë i pijshëm
- Transformator i energjisë elektrike
- Restaurim rruge në lagjen 'Myrs'

Prioritet e Fshatit Pashtresh:

Banori 4:

- Mirëmbajtje e rrugëve kryesore
-

Prioritet e Fshatit Kaferr:


Banori 5:

- Zhavorrim rrugësh që lidh fshatrat Kaferr-Valesh-Xibresh-Pashtresh

Mbyllja e takimit. Ora 11:03

Përgjegjëse e Konsultimeve Publike

Alba Papa





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Proces-verbal

Të dhëna të përgjithshme

Takimi publik për konsultimin e prezantimit : Buxhetimi me Pjesëmarrje, investimet dhe zhvillimi i zonës në fokus- **Njësia Administrative Gracen**

Data e takimit: 22.10.2025

Vendi i takimit: Pranë Njesisë Administrative Gracen

Ora e hapjes së takimit: 10:00

Pjesmarrës në takim gjithsej 26

Femra 1

Meshkuj 25

Kryesuesi i takimit: Nënkryetari I Bashkisë Z.Asim Sula,Deputetja e zonës Znj.Sara Mila , Administrator i Njesisë Administrative Z. Detin Haka,banorë të njesisë .

Zhvillimi i takimit.

Gjatë takimit u diskutuan problematikat kryesore që prekin komunitetin e zonës, si infrastruktura rrugore, ndriçimi publik, uji i pijshëm dhe nevojat arsimore.

Ndër prioritetet për vitin 2026 u evidentuan rindërtimi i shkollës 9-vjeçare në fshatin Gjonmë dhe rikonstruksioni i rrugëve të brendshme në fshatin Dopaj.

Nënkryetari i Bashkisë, z. Asim Sula, theksoi rëndësinë e dëgjimit të komunitetit për të përcaktuar prioritetet në mënyrë demokratike dhe bashkarisht.

Deputetja Sara Mila u shpreh se bashkëpunimi mes pushtetit vendor dhe atij qendror është thelbësor për zhvillimin e zones,ka ende shumë punë për t'u bërë në infrastrukturë dhe furnizimin me ujë, por kemi mundësinë të ecim përpara.

Takimi në Gracen u zhvillua në frymën e dialogut dhe bashkëpunimit, duke vënë në qendër nevojat e komunitetit dhe angazhimin e Bashkisë Elbasan për të ndërtuar një zhvillim të qëndrueshëm e gjithëpërfshirës për çdo njësi administrative.

Banoret votuan për prioritetet :

Prioritet e banorëve të Nj.A Gracen:

Banori 1:

- Shtrim i rrugëve të fshatit
- Uji i pijshëm

Prioritet e Fshatit Mamël:

Banori 2:

- Zhavorrim i rrugës Austostradë-Qendër e fshatit
- Zhavorrim rruga ' Çarja' dhe rruga 'Albasha'

Prioritet e Fshatit Shingjin:

Banori 3:

- Çakullim i rrugëve Nënkallim-Lagjia e Re
- Shtrim i rrugëve të fshatit sipër
- Rikonstruksion i shkollës së fshatit
- Vënia në dispozicion e një infermieri për orarin e pasdites

Prioritet e Fshatit Dopaj:

Banori 4:

- Asfaltim i rrugës kryesore të fshatit

Prioritet e Fshatit Bodin:

Banori 5:

- Çakullim dhe pastrim për rrugët e fshatit
 - Mungesë energjie elektrike
 - Ndërtimi i një qendre shëndetsore në fshat
 - Hapja e rrugës dhe puntorë për rrugët e fshatit që nxënësit të shkojnë në shkollë
-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Prioritet e Fshatit Plangaricë:

Banori 6:

- Shtrim i rrugës kryesore të fshatit
- Tubacione për ujin e pijshëm

Prioritet e Fshatit Pajengë:

Banori 7:

- Shtrim rruge në lagjen e 'Ullinjëve'
- Mungesë e energjisë elektrike

Prioritet e Fshatit Gjorme:

Banori 8:

- Rikonstruksioni i urës së fshatit (8 m)
-

Prioritet e Fshatit Tërbaç:

Banori 9:

- Përfundimi i rrugës tek varrezat
- Puntorë për mirëmbajtjen e rrugëve
- Transport urban për fëmijët që shkojnë në shkollë

Mbyllja e takimit. Ora 11:00

Përgjegjëse e Konsultimeve Publike

Alba Papa





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

KESHILLI BASHKIAK

Proces-verbal

Të dhëna të përgjithshme

Takimi publik për konsultimin e prezantimit : Buxhetimi me Pjesëmarrje, investimet dhe zhvillimi i zonës në fokus- **Njësia Administrative Labinot Fushë**

Data e takimit: 21.10.2025

Vendi i takimit: Pranë Njesisë Administrative Labinot Fushë

Ora e hapjes së takimit: 13:00

Pjesëmarrës në takim gjithsej 40

Femra 5

Meshkuj 35

Kryesuesi i takimit: Nënkryetari I Bashkisë Z.Asim Sula,Deputetja e zonës Znj.Sara Mila , Administrator i Njesisë Administrative Z. Islam Kaçuli,banorë të njësisë .

Zhvillimi i takimit. Gjatë vitit të fundit, Bashkia Elbasan ka investuar në përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe shërbimeve komunitare në të gjithë territorin e njësisë, duke përfshirë, asfaltim i rrugës së lagjes së spitalit, asfaltim i rrugëve të brendshme në lagjet Isak, Bucajvër dhe Shkëmbit. Sistemim dhe pastrim sistematik i kanaleve ujitëse. Sistemim i ujërave të zeza në përroin e Larit dhe zonën e pompave Mëngel.

Rikonstruksion i qendrës shëndetësore Labinot-Fushë, vendosje ndriçimi publik në lagje, pastrim i gurrës së ujit, rehabilitim dhe asfaltim i rrugëve Krastë-Ura e Lizës dhe Behxhet Hyti-Mëngel, dhe rehabilitim i kanalit ujitës në Mëngel.

Në fshatin Godolesh janë realizuar ndërhyrje për rehabilitimin e rrjetit të ujit të pijshëm, shtrimin me çakull të rrugës Shegunë, vendosjen e ndriçuesve publikë në rrugët kryesore si edhe vendosjen e koshave të mbeturinave.

Nënkryetari i Bashkisë, z. Asim Sula, u shpreh se , “Bashkia Elbasan është e angazhuar të sjellë investime të prekshme në çdo lagje e fshat. Rritja e cilësisë së jetesës së qytetarëve është prioriteti ynë kryesor dhe buxhetimi me pjesëmarrje garanton që zëri i banorëve të jetë gjithmonë vendimtar në planifikimin e projekteve të reja.”

Procesi i buxhetimit me pjesëmarrje vijon, me synimin për të ndërtuar një zhvillim të balancuar dhe për të forcuar bashkëpunimin mes Bashkisë dhe komuniteteve lokale.

Prioritet e banorëve të Nj.A Labinot Fushë:

Banori 1:

- Ujë i pijshëm
- Dalje nga Autostrada për në qendër (Bypass)
- Shkarkimi i ujërave te lagjia e 'Bicajve'

Prioritet e Fshatit Mengël:

Banori 2:

- Asfaltim i rrugës së Samurrit (1.8 km)
- KUZ deri tek pompat
- Ndërtimi i një ambulance për fshatin

Prioritet e Fshatit Griqan Poshtë:

Banori 3:

- Shtrim i rrugës së varrezave
- Rrethim i këndit sportiv
- Çakullim i rrugës së 'Muratajve'

Prioritet e Fshatit Griqan Sipër:

Banori 4

- Ujë i pijshëm dhe KUZ

Prioritet e Fshatit Godolesh:

Banori 5:

- Ujë i pijshëm
- Shtrim i rrugës 'Shegune' (4 km)
- Mungesë e energjisë elektrike (kabina nr 5)
- Pastrimi i kanalit Elbasani-Qafë Godolesh
- Uji vaditës Funari (200 m tub)
- Mungesa e ujit dhe e një infermieri në ambulancën e fshatit

Prioritet e Fshatit Xibrakë:

Banori 6:

- Shtrimi i rrugës Xibrakë-Sericë
 - KUZ (Xibrakë Poshtë)
 - Pastrimi i kanalit vaditës
-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Prioritet e Fshatit Xibrakë Sipër:

Banori 7:

- Asfalti i rrugës mal (2.5 km)
- Ndërtimi i një ambulance për fshatin
- Ndriçimi i rrugëve të fshatit
- Uji i pijshëm

Mbyllja e takimit. Ora 14:05

Përgjegjëse e Konsultimeve Publike

Alba Papa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Proces-verbal

Të dhëna të përgjithshme

Takimi publik për konsultimin e prezantimit : Buxhetimi me Pjesëmarrje, investimet dhe zhvillimi i zonës në fokus- **Njësia Administrative Labinot Mal**

Data e takimit: 21.10.2025

Vendi i takimit: Pranë Njesisë Administrative Labinot Mal

Ora e hapjes së takimit: 10:00

Pjesëmarrës në takim gjithsej 45

Femra 5

Meshkuj 40

Kryesuesi i takimit: Nënkryetari I Bashkisë Z.Asim Sula, Deputetja e zonës Znj.Sara Mila , Administrator i Njesisë Administrative Z. Ylber Kuçi, banorë të njësisë .

Zhvillimi i takimit. Gjatë takimit u prezantuan investimet e rëndësishme që Bashkia Elbasan ka realizuar në territorin e Labinotit Mal dhe fshatrave përbërëse, si devijimi dhe hapja e rrugës së njohur si “Balta” në fshatin Gur i Zi, betonizimi dhe sistemimi i rrugëve në Sericë, si dhe pastrimi i rrugëve lidhëse nga qendrat e njësive administrative në fshatrat Shmil, Dritas dhe Qafë etj.

Këto ndërhyrje përfaqësojnë angazhimin e vazhdueshëm të Bashkisë Elbasan për zhvillimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në zonat rurale, duke forcuar lidhjen ndërmjet komuniteteve dhe duke mbështetur potencialet e tyre ekonomike. Labinoti Mal njihet për traditën e bujqësisë, kultivimin e gështenjave e arrave, si dhe për mbarështimin e bletëve dhe prodhimin e mjaltit cilësor, ç’ka e bën këtë njësi të pasur në burime natyrore dhe me potencial për zhvillim të qëndrueshëm.

Nënkryetari Asim Sula nënvizoi se “zëri i qytetarëve është themeli i çdo vendimmarrjeje të drejtë”, duke shtuar se Bashkia Elbasan do të vijojë të investojë në Labinot Mal dhe në çdo njësi tjetër me fokus në infrastrukturë, bujqësi dhe mjedis, për një zhvillim të qëndrueshëm dhe jetë më të mirë për banorët.

Në fund të takimit, banorët e Labinot Malit votuan për prioritetet kryesore të investimeve, të cilat do të shqyrtohen nga Bashkia Elbasan për t’u përfshirë në buxhetin e vitit 2026, duke vijuar kështu traditën e transparencës dhe përfshirjes qytetare në vendimmarrje.

Prioritet e banorëve të Nj.A Labinot Mal:

Banori 1:

- Uji i pijshëm

Prioritet e Fshatit Guri Zi:

Banori 2:

- Uji i pijshëm
- Sistemi i orarit për transportin e nxënësve të shkollës
- Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve të fshatit
- Kabëll ABC në lagjen e 'Rezervave'
- Vendosja e policave të shtrirë në lagjen 'Rranxhi'

Prioritet e Fshatit Benë:

Banori 3:

- Mirëmbajtja e rrugëve të fshatit si dhe shtim i punëtorëve për mirëmbajtje

Prioritet e Fshatit Shmil:

Banori 4:

- Hapja e rrugëve të fshatit me fadromë (4 km)

Prioritet e Fshatit Qerret:

Banori 5:

- Infrastruktura e fshatit
- Uji i pijshëm

Prioritet e Fshatit Sericë:

Banori 6:

- Shtrimi i rrugëve për fshatrat Xibrakë-Sericë-Qafë Qerret-Lugaxhi
 - Infrastruktura e fshatit
 - 800 m linear tuba për ujin e pijshëm
-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Prioritet e Fshatit Lugaxhi:

Banori 7:

- Mungesë e energjisë elektrike
- Rezervuar për ujin mbledhës
- Shtrim i rrugës së fshatit

Prioritet e Fshatit La Mollë:

Banori 8:

- Shtrim i rrugës Xibrakë-Kronë që lidh rrugën e Labinot Katund-Sericë

Mbyllja e takimit. Ora 11:07

Përgjegjëse e Konsultimeve Publike

Alba Papa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Proces-verbal

Të dhëna të përgjithshme

Takimi publik për konsultimin e prezantimit : Buxhetimi me Pjesëmarrje, investimet dhe zhvillimi i zonës në fokus- **Njësia Administrative Papër**

Data e takimit: 22.10.2025

Vendi i takimit: Sheshi Qendër

Ora e hapjes së takimit: 12:00

Pjesëmarrës në takim gjithsej 73

Femra 13

Meshkuj 60

Kryesuesi i takimit: Kryetari I Bashkisë Z.Gledian Llatja, Deputetja e zonës Znj.Sara Mila , Administrator i Njesisë Administrative Z.Arian Vrapit , Anëtar I Këshillit Bashkiak Z.Shefqet Bullari, banorë të njësisë .

Zhvillimi i takimit. Gjatë takimit, Kryetari vuri theksin te investimet e realizuara gjatë këtij viti dhe theksoi se puna do të vijojë me intensitet vitin që vjen.

“Buxhetimi me pjesëmarrje është formati që ndjekim për të përcaktuar investimet në njësitë administrative, por edhe për punët komunale që nevojiten në fshat. Kemi ardhur me shumë investime dhe kemi realizuar më shumë se çfarë ishte parashikuar në listën e prioriteteve. Viti nuk ka mbaruar ende, kemi ende punë për të bërë. Ndërkohë po flasim për buxhetin e vitit 2026 dhe planin trevjeçar, duke vijuar me zhvillimin e Elbasanit dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës në çdo fshat, njësi administrative,” -u shpreh Kryetari.

Ai shtoi se fokusi I Bashkisë nuk është vetëm në zgjidhjen e problemeve imediate të infrastrukturës, por edhe në zhvillimin ekonomik e turizmin.

Përveç Buxhetimit me Pjesëmarrje do të flasim edhe për paketën fiskale. Ne sot në Bashkinë e Elbasanit kemi tarifatat më të ulta sesa Bashkitë e tjera. E kemi 60% më të ulët sesa Tirana, 40% më të ulët sesa Durrësi dhe Fieri. Do të kemi një rritje në tarifën e pastrimit, më tepër në qytet e më pak në zonat rurale. Rritja do të fillojë nga 16%-24% për familjet dhe për bizneset. Nuk rritet as në qytet e as në fshat më shumë se 600 lekë të reja në vit. Në fshat nuk shkon më shumë se 1.900 lekë të reja në vit ndërsa në qytet nuk bëhet më shumë se 2400 lekë të reja në vit. Është një tarifë e ulët pasi edhe makinat e reja që po blejmë, mirmbajtja e koshave dhe ardhja përditë e mjeteve kanë një kosto të caktuar të cilën nuk e mbulojmë dot pavarësisht se po e rrisim nga

16%-24%.Nuk duam ti rrisim tarifat më shumë se çmundemi, tarifat zakonisht kanë 20%-in e vet, do të kemi rritje në tarifën e pastrimit dhe në tarifën e ndriçimit.Koncepti I vetëm i tarifave është që shpenzimet që bën Bashkia duhet të jenë të njëjta me tarifimin që ka popullata.Çdo vit do përpiqemi të kemi një indeksim të çmimit dhe të tarifës së vlerës e cila do të bëhet për ofrimin e shërbimeve.

Ndërsa deputetja, Znj. Sara Mila, vlerësoi procesin e buxhetimit me pjesëmarrje si një praktikë e mirë demokratike.

“Buxhetimi me pjesëmarrje është një ritual shumë I mirë I Bashkisë së Elbasanit, një proces demokratik, dhe shpresoj të na ecë gjatë. Do të ishte mirë ta mbajmë këtë ritual bashkarisht edhe në diskutimet e tjera, në çështje ku duhet të ndërhyjë pushteti vendor.

Do të përpiqem të jem një zë I fortë për ju, të kemi një bashkëpunim shumë të mirë me Bashkinë e Elbasanit dhe do të mundohem të kontribuoj edhe në nivel qeveritar, pasi fuqizimi nga të dyja anët do të sjellë më shumë efektivitet për zonën” .

Në përfundim të takimit, banorët votuan për prioritetet e tyre, të cilat do të shqyrtohen për t’u kthyer në investime konkrete gjatë vitit 2026.

Prioritet e banorëve të Nj.A Papër:

Banori 1:

- Asfaltim i rrugës SMT
- Shtrim i rrugës ‘Beqir Dybeli’ (150 m)

Prioritet e Fshatit Murras:

Banori 2:

- Asfaltim i rrugës Papër-Ura Gracese
- Transport urban për nxënësit e shkollës
- Ujë i pijshëm

Prioritet e Fshatit Balldren:

Banori 3:

- Mungesë uji për vaditje në kanalën e Avalet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Prioritet e Fshatit Papër Sollak:

Banori 4:

- Karikime rrugësh në fshat

Prioritet e Fshatit Vidhas:

Banori 5:

- Zëvendësim i koshave të mbetjeve urbane
- Mungesë kolektori për ujin e pijshëm (ndotje)
- Zhavorrim në rrugën 'Jetishtit' dhe rruga e 'Matraxhinjëve'

Prioritet e Fshatit Bizhutë:

Banori 6:

- Asfaltimi i rrugëve që i shërben 4 fshatrave
- Spostim i linjës elektrike në fshatin e tyre

Prioritet e Fshatit Pajun:

Banori 7:

- Pritat e rrugës
- Zhavorrimi i rrugës kryesore
- Transormator për energjinë elektrike

Prioritet e Fshatit Ullishtë:

Banori 8:

- Ndriçimi i fshatit në rrugën kryesore
 - KUZ dhe Fadromë për rrugën e Ullishtës Lagjia e Kateshëve
 - Shtyllë elektrike në lagjen e 'Tafanëve'
-

Prioritet e Fshatit Valas:

Banori 9:

- Shtrim i rrugës Ura e Zezë-Lagjia e 'Canëve'
- Asfaltim përreth varrezave rruga 'Abedin Koçiu'
- Mungesë e energjisë elektrike
- Vendosja e 4 koshave për mbetjet urbane dhe tuba për ujin e pijshëm

Prioritet e Fshatit Murras Fushë:

Banori 10:

- Shtrim rruge 300 m në rrugën e 'Vrapëve' lagjia 'Vrapi'
- Uji i pijshëm

Prioritet e Fshatit Balldren:

Banori 11:

- Shtrimi i rrugës së fshatit
- Shtrimi i rrugës së ullishtës

Prioritet e Fshatit Broshkë:

Banori 12:

- Shtrimi i rrugës dytësore lagjia 'Lleshaj'

Mbyllja e takimit. Ora 13:00

Përgjegjëse e Konsultimeve Publike

Alba Papa





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Proces-verbal

Të dhëna të përgjithshme

Takimi publik për konsultimin e prezantimit : Buxhetimi me Pjesëmarrje, investimet dhe zhvillimi i zonës në fokus- **Njësia Administrative Shushicë**

Data e takimit: 16.10.2025

Vendi i takimit: Pranë Njesisë Administrative Shushicë

Ora e hapjes së takimit: 10:00

Pjesmarrës në takim gjithsej 63

Femra 21

Meshkuj 42

Kryesuesi i takimit: Kryetari I Bashkisë Z.Gledian Llatja,Kryetar I Këshillit Bashkiak Z.Lutfi Lala , Administrator i Njesisë Administrative Z. Sokol Sinani,banorë të njësisë .

Zhvillimi i takimit. Kryetari theksoi se Bashkia Elbasan ka hyrë në një fazë të re investimesh, me mbështetje nga qeveria dhe fonde të siguruara përmes lobimit vendor.

“Prioritet për vitin e ardhshëm është lidhja e Shushicës me urën e Byshekut dhe ndërtimi i bypass-it, që do ta kthejë Shushicën në një lagje të Elbasanit.

Kemi projekte të rëndësishme në infrastrukturë, në arsim dhe në sistemet e ujitjes e energjisë,” deklaroi Kryetari.

Ai shtoi se brenda nëntorit do të nisin punimet për ndërtimin e shkollës së re 9-vjeçare në Shushicë, ndërsa po punohet edhe për një shkollë shtesë në Hajdaran.

“Kemi nisur fazën e parë me vendosjen e koshave dhe pritet të mbërrijnë edhe 200 të tjerë, bashkë me mjetet e reja të pastrimit.”, theksoi Kryetari.

Përveç Buxhetimit me Pjesëmarrje do të flasim edhe për paketën fiskale.Ne sot në Bashkinë e Elbasanit kemi tarifatat më të ulta sesa Bashkitë e tjera.E kemi 60% më të ulët sesa Tirana, 40% më të ulët sesa Durrësi dhe Fieri.Do të kemi një rritje në tarifën e pastrimit, më tepër në qytet e më pak në zonat rurale.Rritja do të fillojë nga 16%-24% për familjet dhe për bizneset.Nuk rritet as në qytet e as në fshat më shumë se 600 lekë të reja në vit.Në fshat nuk shkon më shumë se 1.900 lekë të reja në vit ndërsa në qytet nuk bëhet më shumë se 2400 lekë të reja në vit.Është një tarifë e ulët pasi edhe makinat e reja që po blejmë,mirmbajtja e koshave dhe ardhja përditë e mjeteve kanë një kosto të caktuar të cilën nuk e mbulojmë dot pavarësisht se po e rrisim nga 16%-24%.Nuk duam ti rrisim tarifatat më shumë se çmudemi, tarifatat zakonisht kanë 20%-in e

vet, do të kemi rritje në tarifën e pastrimit dhe në tarifën e ndriçimit. Koncepti I vetëm i tarifave është që shpenzimet që bën Bashkia duhet të jenë të njëjta me tarifimin që ka popullata. Çdo vit do përpiqemi të kemi një indeksim të çmimit dhe të tarifës së vlerës e cila do të bëhet për ofrimin e shërbimeve.

Kryetari I Këshillit Bashkiak, Lutfi Lala, vlerësoi punën e bërë gjatë vitit 2025 dhe bashkëpunimin me qytetarët. Ai theksoi se si bashki dhe këshill janë të angazhuar të japin llogari për çdo veprim dhe investim të bërë.

Në përmbyllje të takimit, banorët votuan për prioritetet kryesore të investimeve që do të përfshihen në buxhetin e vitit 2026, në përputhje me kërkesat dhe nevojat e tyre më emergjente për zonën.

Prioritet e banorëve të Nj.A Shushicë:

Banori 1:

- Vendosja e një pusete grumbullimi
- Pastrimi i kanaleve
- Rikonstruksion metalik për varrezat e fshatit
- Mungesë e ujit vaditës
- Ujë i pijshëm në lagjen Rrozë (sistemim i sahatëve të ujit)

Prioritet e Fshatit Vreshtan:

Banori 2:

- Shtrim i rrugës së sektorit Vreshtan
- Hapja e rrugës që lidh Hajdaran-Vreshtan (rrugë arash)
- Pastrim i mbetjeve urbane dhe shtim koshash
- Mungesë e ujit vaditës
- Zgjerim rruge tek magazinat
- Sistemimi i orarit të ujit të pijshëm

Prioritet e Fshatit Hajdaran:

Banori 3:

- Vazhdimi i asfaltimit të rrugës kryesore të fshatit
- KUZ
- Fadromë për hapjen e rrugës tek ullinjtë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Prioritet e Fshatit Polis Vale:

Banori 4:

- Asfaltim i rrugës së fshatit (1.5 km)
- Rikonstruksion i rrugëve tek lagjia 'Nonëve'

Prioritet e Fshatit Polis i Vogël:

Banori 5:

- Sistemim dhe asfaltim për rrugën kryesore të fshatit
- Rikonstruksion i Urës së Varur
- Kanali Vaditës
- Ndriçimi i fshatit
- Uji i pijshëm (10 familje)

Prioritet e Fshatit Mlizë:

Banori 6:

- Pastrimi i koshave të mbetjeve urbane
- Fadroma për rrugën në lagjen e Mlizës

Prioritet e Fshatit Fush-Bull:

Banori 7:

- Çakullim i rrugës së varrezave të poshtme
 - Pastrimi i koshave të mbetjeve urbane
 - Uji i pijshëm
 - Investim në kanalin vaditës të fshatit
-

Prioritet e Fshatit Shelcan:


Banori 8:

- Ujë i pijshëm
- Shtim i koshave të mbetjeve urbane
- Shtrim me çimento tek rruga e varrezave

Mbyllja e takimit. Ora 11:11

Përgjegjëse e Konsultimeve Publike

Alba Papa





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Proces-verbal

Të dhëna të përgjithshme

Takimi publik për konsultimin e prezantimit : Buxhetimi me Pjesëmarrje, investimet dhe zhvillimi i zonës në fokus- **Njësia Administrative Tregan**

Data e takimit: 17.10.2025

Vendi i takimit: Palestra Jonuz Çarçiu

Ora e hapjes së takimit: 14:00

Pjesëmarrës në takim gjithsej 52

Femra 20

Meshkuj 32

Kryesuesi i takimit: Kryetari I Bashkisë Z. Gledian Llatja, Deputetja e zonës Znj. Evis Kushi, Administrator i Njesisë Administrative Z. Mërkur Kaçi, banorë të njësisë.

Zhvillimi i takimit. Në kuadër të procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje, Kryetari i Bashkisë Elbasan, Gledian Llatja dhe deputetja Evis Kushi zhvilluan një takim me banorët e Njesisë Administrative Tregan.

Takimi u mbajt në ambientet e shkollës së re “Jonuz Carçiu”, një nga investimet më të rëndësishme të realizuara në këtë zonë gjatë vitit paraardhës.

Kryetari theksoi se gjatë dy viteve të fundit janë realizuar investime të konsiderueshme në këtë njësi. Vetëm në këto dy vite, në Tregan kemi realizuar mbi 2 milionë euro investime në infrastrukturë shkollë dhe rrugë, -u shpreh ai.

Duke u ndalur fillimisht te shkolla “Jonuz Carçiu”, kjo shkollë ka qenë një nga kërkesat më të shumta të banorëve. Ishte një shkollë problematike për shumë vite, por tashmë kemi arritur ta kthejmë në një institucion modern që u shërben fëmijëve të zonës.”

Përmirësimin e rrugëve dhe infrastrukturës në Tregan, ishte një tjetër aspekt ku u ndal kryetari duke shtuar se “janë realizuar rruga e Kyçykëve, rrugët e brendshme të fshatit Tregan, si edhe pjesa e dytë e vazhdimin të rrugës që lidh Treganin dhe fshatin Kyçyk me Cërrikun. Të gjitha këto janë investime që po e zhvillojnë ndjeshëm zonën.”

Ai vuri theksin te potenciali i madh zhvillimor i zonës, veçanërisht në turizëm.

“Në Tregan kemi një potencial të madh, ujin termal të Llixhës, turizmin dhe numrin më të madh të shtretërve në Bashkinë e Elbasanit. Do ta mbajmë Treganin në qendër të vëmendjes dhe do të mbështesim komunitetin për të vijuar punët e mira e për të zgjidhur problematikat që ekzistojnë”.

